



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljeno / Predato Received / Delivery	14.06.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org / Unit	In Prot In Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMBAK	3474/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 451/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani kryetar, Malësore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional për shqyrtimin e ankesës A. Nr. 451/2022, të datës 13.05.2022, të ankueses me adresë banimi: Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “Kompensimi Material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 14.06.2022, mori këtë;

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.451/2022 e datës 13.05.2022, e parashtruar nga ankuesja

II. MBETET në fuqi Vendimi me nr.104 i Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve i datës 23.03.2022.

A r s y e t i m

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve, me datë 23.03.2022 ka nxjerr vendim me numër 104 lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, për nëpunësen civile Sanije Kelmendi, duke i njohur të drejtën e një pagë përcjellëse në rastin e pensionimit.

Ankuesja pakënaqur me vendimin me numër 104, të datës 23.03.2022 të Zëvendës Sekretarit i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve, në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me datë 13.05.2022 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, me pretendimet ankimore se organi i punësimit me rastin e pensionimit të saj duhet ti bëjë pagesën e tri (3) pagave, pas arritjes së moshës së pensionimit ndërsa ankueses i është bërë pagesa e vetëm një page.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankesën e ankueses e ka dërguar tek Ministria e Financave Punës dhe Transfereve për përgjigje në ankesë me datë 23.05.2022, ndërsa me datën 02.06.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, me provat e bashkangjitura .

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.protokolli 2773/2022 të datës 13.05.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim me numër protokolli 104 i datës 23.03.2022; E-mail nga XH.D. për A.H. i datës 12.05.2022; E-mail nga S.A. për XH.D. i datës 25.03.2022; E-mail nga M.M. për S.A. i datës 25.03.2022; E-mail nga A.SH. për zyraesekretarit.mf@rks-gov.net i datës 25.03.2022; Lista e pagave e datës 01.02.2022 deri 28.02.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 23.05.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 3210/2022 e datës 02.06.2022; E-mail nga A.H. për A.B. i datës 30.05.2022; E-mail nga A.B. për A.H. i datës 27.05.2022; E-mail nga B.H. për A.B. i datës 27.05.2022; Përvoja e punës e ankueses e datës 27.04.2022; Akt Emërimi i S.K. i datës 16.04.2014; PAGESA lidhur me pensionimin e ankueses e datës 01.04.2022 deri 30.04.2022; Formulari i të dhënave për listën e pagave i datës 01.04.2022; Kërkesë për pagesë retroaktive e S.K.; E-mail nga A.B. për C.Z. i datës 02.06.2022; E-mail nga A.B. për C.Z. i datës 31.05.2022; E-mail nga A.H. për A.B. i datës 30.05.2022; E-mail nga A.B. për A.H. i datës 27.05.2022; E-mail nga B.H. për A.B. i datës 27.05.2022;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pa bazuar sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës parashih që punëtorëve ju takon pagesa në lartësi prej tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, njëherit ka konstatuar se ankuesja sipas aktit të emërimit të datës 16.04.2014 me numër:223 është e punësuar në Ministria e Financave Punës dhe Transfereve në pozitën *“Zyrtare për vendime dhe PAGESA”*, respektivisht e njëjta e ka statusin e nëpunëses civile dhe mbi këtë bazë e drejta në pagë dhe kompensime me rastin e daljes në pension rregullohet me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 sipas nenit 82 të saj, ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, sikurse: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”*, mirëpo neni 81 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, respektivisht paragrafi 1 ka përcaktuar që: *“Nga Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës”*, bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Neni 82 paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës përcakton se: *“Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit”*, mirëpo meqenëse njëri nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje është tërheq nga zbatimi i saj tre muaj para skadimit të përcaktuar, e njëjta nuk vlen nga data e tërheqjes.

Meqenëse konstatohet se nga data 15.09.2017 Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është e zbatueshëm, rrjedhimisht nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike sepse më nuk është nënshkruar nga institucionet kompetente. Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka konstatuar se marrëdhënia e punës së ankueses me rastin e pensionimit i ka përfunduar sipas Vendimit me numër 104 të



datës 23.03.2022, atëherë kompensimi i tri pagave me rastin e pensionimit sipas Marrëveshjes Kolektive të Kosovës nuk mund të bëhet.

Mirëpo, Kolegji ka konstatuar se me Vendimin numër 104 të datës 23.03.2022 ankueses i është njohur edhe e drejta e kompensimit në vlerën e një (1) page me rastin e pensionimit, respektivisht sipas shkresës me shifër KCB/BL7754 të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, ankueses i është bërë kompensimi i një page mujore të njehershme në vlerën e pagesë së fundit, andaj Ministria e Financave Punës dhe Transfereve ka vepruar në pajtueshmëri me neni 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë i cili përcakton që: **“Paragrafi 1. Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit”.** **Paragrafi 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njehershme në vlerën e pagesë së fundit”,** ndërsa pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Vendimi me nr. 104, i datës 23.03.2022 i Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe neni 22 paragrafi 2.2. pagesën për shkak të pensionimit të Ligjit nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil në Republikën e Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda Nr. A. Nr.451/2022

Çlirim Zeka


Procesmbajtës



Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve;
- Arkivit të KPMSHCK-së

